URDHËR
Nr. 88, datë 20.6.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Integrimit Europian, zëvendësministrit të Ministrisë së Integrimit Europian, znj. Eralda Çani, për miratimin e kryerjes së pagesës së pagave në kuadër të asistencës teknike të programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC Greqi-Shqipëri, kompetenti II.
2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Integrimit Evropian do të ushtrohen për periudhën nga data 20.6.2016, pas orës 12:00 A.M., deri më 21.6.2016.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Integrimit Europian, znj. Eralda Çani.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN
Klajda Gjosha